



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3294/ 7 Prot.

Datë 11/12/2025

V E N D I M

Nr. 1841/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11/12/2025 me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TEA-D” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me numër reference Nr. REF-62042-09-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i kabinave dhe rrjetit TU me ABC në fiderin e Kardhiqit (në fshatrat Zhulat, Çepunë, Taroninë, Fushë Bardhë, Golem, Kolonjë, Mendar, Prongji, Labovë, Andon Poç, Tëbuq, Hundë Kuq)”, me fond limit 69.982.066,54leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastrë.

Ankimues: Operatori ekonomik “TEA-D” SHPK me NIPT: K32522629L dhe me adresë: Rruga “Dhuvjan” , nr.pasurie 3105, ZK 2444, Gjirokastrë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastrë
Adresa: Blv. “18 Shtatori”, pallati 6-katësh përballë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me numër reference Nr. REF-62042-09-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i kabinave dhe rrjetit TU me ABC në fiderin e Kardhiqit (në fshatrat Zhulat, Çepunë, Taroninë, Fushë Bardhë, Golem, Kolonjë, Mendar, Prongji, Labovë, Andon Poç, Tëbuq, Hundë Kuq)”, me fond limit 69.982.066,54leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastrë.

II.2. Në datë 16.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se në datën 30.10.2025 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. "TEA-D" SHPK	53.759.102,78 leke	skualifikuar
2. "L.T.E CONSTRUCTION" SHPK	62.221.487,90 leke	skualifikuar
3. "HTM" SHPK	67.883.842,52 leke	kualifikuar

II.4. Në datën 30.10.2025, operatori ekonomik "TEA-D" ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

"1. Sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), kandidati ofertues duhet të përcaktojë, me anë të një deklarate të lëshuar nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarohet se:

- nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, dhe
- do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Kjo deklaratë duhet të shoqërohet me dokumentacionin mbështetës si më poshtë:

i. Librezën e punës (përkatëse);

ii. CV-në përkatëse;

iii. Kontratën e punës të vlefshme (përkatëse).

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se:

- Është paraqitur deklarata e administratorit të shoqërisë për përcaktimin e drejtuesit teknik të punimeve;

• Megjithatë, mungojnë dokumentet shoqëruese të kërkuara, konkretisht librezja e punës, CV-ja dhe kontrata e punës e vlefshme për drejtuesin teknik. Në mungesë të këtyre dokumenteve, operatori ekonomik nuk ka provuar në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme kapacitetin teknik dhe profesional që lidhet me drejtuesin teknik të punimeve, sipas kërkesave të DST.

2. Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 21 (njëzet e një) punonjës elektrikistë, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, me kontrata pune të vlefshme dhe dëshmi profesionale përkatëse, ku minimalisht 5 (pesë) prej tyre duhet të jenë të pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit Teknik (të vlefshme).

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se:

- OE ka paraqitur deklaratën për personelin teknik, në të cilën janë listuar 20 punonjës elektrikistë;
- Në këtë mënyrë, nuk përmbushet kërkesa minimale e përcaktuar në DST për numrin e punonjësve (21 punonjës);
- Për pasojë, operatori nuk plotëson kriterin e kapacitetit teknik në lidhje me personelin elektrikist të kërkuar.

Në këto kushte, operatori ekonomik nuk përmbush kërkesën e detyrueshme të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.8 të DST, që lidhet me zotërimin e personelit minimal të kërkuar për kryerjen e punimeve.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik skualifikohet nga procedura e prokurimit për mosplotësim të kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, në aspektin e personelit të kualifikuar elektrikist.

3. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, u konstatua se katalogët dhe/ose specifikimet teknike të produkteve të ofruara janë dorëzuar në gjuhë të huaj pa përkthim në gjuhën shqipe. Sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, operatori ekonomik është i detyruar të paraqesë katalogë ose fragmente të katalogëve të prodhuesit për produktet e ofruara, ku të dhënat teknike bazë të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të mundësohet një vlerësim i saktë dhe transparent i përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Mosrespektimi i kësaj kërkesë përbën mospërmbushje të një kriteri teknik të domosdoshëm dhe, si i tillë, sjell si pasojë skualifikimin e operatorit ekonomik nga procedura e prokurimit”. ”.

II.5. Në datën 11.11.2025, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim – Fituesit Paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi janë shpallur fitues paraprak oferta e operatorit ekonomik “HTM” ShPK.

II.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/6083, datë 17.11.2025 dhe me numër protokoll nr. 3294/2025 prot, datë 17.11.2025 e operatorit ekonomik “TEA-D” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.7 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3294/1 prot., datë 18.11.2025, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.8. Me shkresën nr 655/17 prot., datë 27.11.2025 me objekt “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me numër nr. 3294/2 prot, datë 03.12.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresë nr. 655/16 prot, datë 26.11.2025 “Shqyrtim ankese”, ku Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor ka vendosur të mos pranojë pretendimet e ankimuesit me argumentat si më poshtë vijon:

“Bazuar në Urdhërin Nr. 655/15 prot., datë 19.11.2025, për pezullimin e procedurës dhe shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga Operatorit Ekonomik "TEA D" shpk, me NIPT K32522629L, e regjistruar me nr. aplikimi ankese online A/2025/6083, si dhe të administruar

në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3294/ Prot, datë 17.11.2025, me status të mandatit të pagesës "Pa Paraqitur", lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit me:

- *Numër reference: REF-62042-09-19-2025*
- *Objekt: "Rikonstruksion i kabinave dhe rrjetit TU me ABC në fiderin e Kardhiqit (në fshatrat Zhulat, Çepunë, Taroninë, Fushë Bardhë, Golem, Kolonjë, Mendar, Prongji, Labovë, Andon Poç, Tëbuq, Hundë Kuq)"*
- *Afati i punimeve: 10 muaj nga dorëzimi i sheshit*
- *Fondi limit: 69,982,066.54 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e katër) leke pa TVSH*

Si dhe në bazë të:

- *Ligjit Nr. 162/2020, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,*
- *VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar,*

Nga KSHA në datën 19.11.2025 ka nisur shyrtime të dokumentacionit të paraqitur për ankesën e bërë nga operatori ekonomik.

Referuar të dhënave të pasqyruara në bazën e të dhënave të KPP-së, rezulton se në rubriken "Statusi i mandatit të pagesës" shfaqet gjendja "I pa paraqitur", dhe për rrjedhojë mandati i pagesës nuk i është bashkëlidhur ankesës së depozituar. (bashkëlidhur portali i faqes zyrtare)

Në përputhje me nenin 94, pika 3 dhe 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), ku parashikohet se:

"Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementëve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin..."

Nga ana e njësisë së prokurimit, në datën 19.11.2025, i është dërguar operatorit ekonomik dhe për dijeni KPP një njoftim elektronik, në të cilin sqarohej se mandati i pagesës vijon ende i palikuiduar. Në këtë njoftim, ndër të tjera, citohej se:

"Në këto kushte, brenda afatit të përcaktuar nga neni 94, pika 5 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (dy ditë nga marrja e këtij njoftimi; afati i fundit në rastin konkret: dt. 21.11.2025, ora 15:00), jeni të lutur të plotësoni ankesën, pasi në të kundërt kjo ankesë do të vlerësohet si e paparaqitur.".

Gjatë kohës së lënë në dispozicion për plotësimin e dokumentacionit, operatori ekonomik nuk ka kthyer asnjë përgjigje, as në menyrë elektronike dhe as nëpërmjet rrugës postare. (bashkëlidhur emaili)

Nga ana jonë, si KSHA, në datën 21.11.2025, në respektim të afatit të pritjes së përcaktuar nga Njësia e Prokurimit për operatorin ekonomik, i është kthyer përgjigje Njësisë së Prokurimit nëpërmjet komunikimit elektronik (si bashkëlidhur), ku është bërë me dije se:

Deri në datën 21.11.2025 ora 16.00 nuk është marrë asnjë informacion lidhur me mandatin e pagesës së operatorit ekonomik "TEA-D" shpk, mandat të cilin operatori duhej ta paraqiste brenda afateve të përcaktuara, si dhe ngarkimin e ankesës së plotë. Në mungesë të këtij informacioni, u krye përsëri verifikimi përkatës në faqen zyrtare të KPP, ku rezultoi se mandati i pagesës vijon ende me statusin "i pa paraqitur". Në këto kushte, nga ana jonë nuk është e mundur të vijojmë me shqyrtimin e ankesës deri në një informim të ri.

...

Referuar Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar (me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; dhe Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024), neni 94, pika 5, parashikon se:

"Ankesa duhet të korrigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur."

A: Rr. "18 Shtatori", Pallati 6 kate, përballe Gjykates se Shk.I-re te Juridiksionit te

Duke qënë se operatori ekonomik nuk ka plotësuar brenda afatit ligjor mangësinë e evidentuar (mosparaqitja e mandatis të pagesës dhe ankesës së plotë), si dhe pas verifikimit rezulton se mandati i pagesës vijon ende me statusin "i pa paraqitur", (bashkëlidhur portali i faqes zyrtare) në këto kushte KSHA nuk mund të vijojë me shqyrtimin e ankesës.

Për rrjedhojë, ankesa vlerësohet si e paparaqitur dhe KSHA vendos ndërprerjen e procedurës së shqyrtimit të saj."

II.9. Me memon nr. 3294/3 prot., datë 05.12.2025, i është kërkuar Sektorit të Financës (këtu) informacion, nëse operatori ekonomik ankimues "TEA-D" SHPK., ka paraqitur apo jo pranë KPP, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës për ankesën e paraqitur për procedurën objekt - ankimi.

II.10. Me shkresën nr. 3294/4 prot., datë 11.12.2025, Sektori i financës informon se: "Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3294/3 prot., datë 05.12.2025, me lëndë: "Kërkesë për verifikim pagese", ju bëjmë me dije SI MË POSHTË:

Për ankesën me nr. 3294/2025 prot., datë 17.11.2025 me numër aplikimi elektronik A/2025/6083, Operatori ekonomik "TEA-D" Shpk nuk ka paraqitur dokument në seksionin mandat pagese.

Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 27.11.2025, të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e muajit Nëntor, ku rezulton se Operatori Ekonomik "TEA-D" Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik."

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

II.1. Lidhur me ankesën e administruar në datën 17.11.2025 nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave nga operatori ekonomik “TEA-D” SHPK, me nr. A/2025/6083 dhe nr. 3294/2025 prot, datë 17.11.2025, në procedurën e prokurimit “E hapur” me numër reference Nr. REF-62042-09-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i kabinave dhe rrjetit TU me ABC në fiderin e Kardhiqit (në fshatrat Zhulat, Çepunë, Taroninë, Fushë Bardhë, Golem, Kolonjë, Mendar, Prongji, Labovë, Andon Poç, Tëbuq, Hundë Kuq)”, me fond limit 69.982.066,54leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastrë, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TEA-D” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

- “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.
2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.
3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.
4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Me shkresën nr 655/17 prot., datë 27.11.2025 me objekt “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me numër nr. 3294/2 prot, datë 03.12.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresë nr. 655/16 prot, datë 26.11.2025 “Shqyrtim ankese”, ku Komisioni

i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor ka vendosur të mos pranojë pretendimet e ankimuesit me argumentat si më poshtë vijon:

“Bazuar në Urdhërin Nr. 655/15 prot., datë 19.11.2025, për pezullimin e procedurës dhe shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga Operatorit Ekonomik "TEA D" shpk, me NIPT K32522629L, e regjistruar me nr. aplikimi ankese online A/2025/6083, si dhe të administruar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 3294/ Prot, datë 17.11.2025, me status të mandatit të pagesës "Pa Paraqitur", lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit me:

- Numër reference: REF-62042-09-19-2025
- Objekt: "Rikonstruksion i kabinave dhe rrjetit TU me ABC në fiderin e Kardhiqit (në fshatrat Zhulat, Çepunë, Taroninë, Fushë Bardhë, Golem, Kolonjë, Mendar, Prongji, Labovë, Andon Poç, Tëbuq, Hundë Kuq)"
- Afati i punimeve: 10 muaj nga dorëzimi i sheshit
- Fondi limit: 69,982,066.54 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e katër) leke pa TVSH

Si dhe në bazë të:

- Ligjit Nr. 162/2020, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,
- VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar,

Nga KSHA në datën 19.11.2025 ka nisur shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ankesën e bërë nga operatori ekonomik.

Referuar të dhënave të pasqyruara në bazën e të dhënave të KPP-së, rezulton se në rubriken "Statusi i mandatit të pagesës" shfaqet gjendja "I pa paraqitur", dhe për rrjedhojë mandati i pagesës nuk i është bashkëlidhur ankesës së depozituar. (bashkëlidhur portali i faqes zyrtare)

Në përputhje me nenin 94, pika 3 dhe 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), ku parashikohet se:

"Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementëve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin..."

Nga ana e njësisë së prokurimit, në datën 19.11.2025, i është dërguar operatorit ekonomik dhe për dijeni KPP një njoftim elektronik, në të cilin sqarohej se mandati i pagesës vijon ende i palikuiduar. Në këtë njoftim, ndër të tjera, citohej se:

"Në këto kushte, brenda afatit të përcaktuar nga neni 94, pika 5 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (dy ditë nga marrja e këtij njoftimi; afati i fundit në rastin konkret: dt. 21.11.2025, ora 15:00), jeni të lutur të plotësoni ankesën, pasi në të kundërt kjo ankese do të vlerësohet si e paparaqitur.".

Gjatë kohës së lënë në dispozicion për plotësimin e dokumentacionit, operatori ekonomik nuk ka kthyer asnjë përgjigje, as në menyrë elektronike dhe as nëpërmjet rrugës postare. (bashkëlidhur emaili)

Nga ana jonë, si KSHA, në datën 21.11.2025, në respektim të afatit të pritjes së përcaktuar nga Njësia e Prokurimit për operatorin ekonomik, i është kthyer përgjigje Njesisë së Prokurimit nëpërmjet komunikimit elektronik (si bashkëlidhur), ku është bërë me dije se:

Deri në datën 21.11.2025 ora 16.00 nuk është marrë asnjë informacion lidhur me mandatin e pagesës së operatorit ekonomik "TEA-D" shpk, mandat të cilin operatori duhej ta paraqiste brenda afateve të përcaktuara, si dhe ngarkimin e ankesës së plotë. Në mungesë të këtij informacioni, u krye përsëri verifikimi përkatës në faqen zyrtare të KPP, ku rezultoi se mandati i pagesës vijon ende me statusin "i pa paraqitur". Në këto kushte, nga ana jonë nuk është e mundur të vijojmë me shqyrtimin e ankesës deri në një informim të ri.

...

Referuar Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar (me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021; Vendimin Nr. 498, datë 01.08.2024; dhe Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024), neni 94, pika 5, parashikon se:

"Ankesa duhet të korrigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur."

A: Rr. "18 Shtatori", Pallati 6 kate, përballe Gjykates se Shk.I-re te Juridiksionit te

Duke qënë se operatori ekonomik nuk ka plotësuar brenda afatit ligjor mangësinë e evidentuar (mosparaqitja e mandatis të pagesës dhe ankesës së plotë), si dhe pas verifikimit rezulton se mandati i pagesës vijon ende me statusin "i pa paraqitur", (bashkëlidhur portali i faqes zyrtare) në këto kushte KSHA nuk mund të vijojë me shqyrtimin e ankesës.

Për rrjedhojë, ankesa vlerësohet si e paparaqitur dhe KSHA vendos ndërprerjen e procedurës së shqyrtimit të saj."

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk çënon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr 655/17 prot., datë 27.11.2025 me objekt “*Kthim përgjigje*” protokolluar me tonën me numër nr. 3294/2 prot, datë 03.12.2025, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes postës elektronike në adresën e postës elektronike, si në vijim: “*d.thanasi1@gmail.com*”, të deklaruar nga ankimuesi në formularin e ankesës, i ka kërkuar operatorit ekonomik “*TEA-D*” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (*më datë 20.11.2025*) operatorin ekonomik ankimues përmes sistemit elektronik të ankesave, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës, ndërkohë që referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga autoritetit kontraktor me shkresën nr 655/17 prot., datë 27.11.2025 me objekt “*Kthim përgjigje*” protokolluar me tonën me numër nr. 3294/2 prot, datë 03.12.2025, konstatohet se operatori ekonomik ankimues “*TEA-D*” SHPK nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë të autoritetit kontraktor, duke mos rregulluar të metat e ankesës.

Gjithashtu me shkresën nr. 3294/4 prot., datë 11.12.2025, lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së operatorit ekonomik “*TEA-D*” SHPK, Sekori i Financës pranë KPP, informon se: “*Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 3294/3 prot., datë 05.12.2025, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije SI MË POSHTË:*

Për ankesën me nr. 3294/2025 prot., datë 17.11.2025 me numër aplikimi elektronik A/2025/6083, Operatori ekonomik “TEA-D” Shpk nuk ka paraqitur dokument në seksionin mandat pagese.

Në vijim të shkresës tuaj janë kryer verifikime me raportin e datës 27.11.2025, të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e muajit Nëntor, ku rezulton se Operatori Ekonomik “TEA-D” Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TEA-D” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me numër reference Nr. REF-62042-09-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i kabinave dhe rrjetit TU me ABC në fiderin e Kardhiqit (në fshatrat Zhulat, Çepunë, Taroninë, Fushë Bardhë, Golem, Kolonjë, Mendar, Prongji, Labovë, Andon Poç, Tëbuq, Hundë Kuq)”, me fond limit 69.982.066,54leke pa TVSH, zhvilluar në datën 16.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastrë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

